



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 37 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 4160 prot., datë 15.08.2024, referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Këshilli i Lartë Gjyqësor është organi qeverisës i sistemit gjyqësor, i ngarkuar nga Kushtetuta për të siguruar pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë dhe ushtron veprimtarinë e tij në bazë të kompetencave të parashikuara në dispozitat kushtetuese si dhe në ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 1, të nenit 16 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, në kushtet kur trajtimi i kërkesës tuaj për informacion kërkon më shumë kohë se afati i parashikuar në pikën 1, të nenit 14, të këtij ligji, për shkak të mbledhjes së informacioneve përkatëse nga gjykatat respektive, ju bëjmë me dije se, informacioni i kërkuar do t’ju përcillet brenda një afati të arsyeshëm.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!